



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.51/2019

Prishtinë, më 3 maj 2019

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Shemsi Syla, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavljeviq dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari-Avokat i Popullit, Mehdi Geci dhe Tafil Rrahmani-IAP, Latife Neziri-Handikos, Teuta Prekazi-UN, Yllka Alimusaj-KDI, Emine Jakupi-praktikante, Ismet Azizi-Kosova për Sanxhakun dhe Selma Gegiq-organizacija SDA.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit. Komisioni i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

1. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2018;
2. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin nr.06/L-084 për mbrojtjen e Fëmijës;
3. Të ndryshme.

\*\*\*

1. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2018**

Kryetarja tha se sot në rend dite kemi shqyrtimin e Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2018, prezent kemi edhe Avokatin e Popullit, i cili do të prezanton këtë raport në komision.

Hilmi Jashari tha se po e bën një përshkrim të shkurtër të tri shtyllave të pushtetit për të pasqyruar gjendjen e të drejtave të njeriut në mënyrë reale. Sa i përket sistemit legjislativ në vend kemi evidentuar katër probleme sistematike që duhet kushtuar vëmendje, krahas viteve paraprake, vazhdon të mbetet problematike miratimi i numrit të madh të ligjeve që janë me plotësim ndryshime nga vitet paraprake dhe që sipas vlerësimit është një dëshmi për kualitetin e dobët për ligjet që vinë nga sektori i qeverisë. Për këtë arsye plotësohen dhe ndryshohen shpesh, problemi i dytë është kodifikimi i së drejtës, problemi i tretë sistematik është mungesa e fjalorit të terminologjisë juridike, dhe ndodh që në një ligj përdoret një terminologji tjetër që ka një kuptim krejt tjetër e në ligjin tjetër për të njëjtën gjë përdoret terminologji krejt tjetër e që shkakton jo konsistencë juridike dhe shkakton problem të madh të zbatuesit e ligjeve, dhe i fundit është përkthimi i dobët i teksteve të ligjeve dhe nuk ofron siguri juridike.

Sa i përket sistemit gjyqësor kemi vërejtur se një pjesë e madhe e qytetarëve të vendit ballafaqohen me moszbatim të kushtetutës, e kjo ka të bëjë me vite të tëra. Ka procedura të hapura gjyqësore, mirëpo gjykata assesi nuk arrin me i zgjidh këto konteste, kemi rekomanduar hartimin e një ligji procedural i cili do të mundësonte qytetarëve që të kompensohen kur shteti shkel të drejtën dhe deri më tani nuk ka asnjë nismë. Problemi i dytë ka të bëjë me dhomën e veçantë të gjykatës supreme, që vendos zakonisht për ankesat e punëtorëve gjatë procesit të privatizimit, numri i rasteve çfarë është në gjykatë dhe në proporcion me numrin e gjyqtarëve nuk do të mund të arrin t'i shqyrtojnë ato lëndë për 10 apo 20 vite nuk do të mund të arrin t'i shqyrtojnë vetëm këto lëndë që janë në procedim dhe problemi i tretë në sistemin e drejtësisë është mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

Sa i përket sistemit ekzekutiv si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, tha se kanë ardhur në konkludim se sistemi ekzekutiv në tërësi vuan nga mungesa e kontrollit efektiv, në një raport të më hareshme kemi konstatuar se Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur sa duhet me mbajt qeverinë përgjegjëse dhe llogaridhënëse, problemi i dytë është heshtja e administratës, problemi i tretë është kushtëzimi i qytetarëve për përmbushjen e detyrimeve të padrejta dhe të paligjshme. Ai me tutje prezantoi edhe çështje të tjera të cilat i ka evidentuar hollësisht në raport.

Kryetarja pyeti se a ka ndonjë gjetje pozitive në funksionimin e sistemit.

Hilmi Jashari tha se në shtyllat e sistemit nuk mund të them se ka pasur ndonjë përmirësim, me përjashtim të Kuvendit që vërehet një ngritje graduale e zvogëlimit të numrit të ligjeve që shkojnë për çdo vit në plotësim ndryshim në Kuvend.

Teuta Haxhiu tha se pozitive është vetëdijesimi i qytetarëve për te pasur një adresë dhe kjo është në nivelin më të lartë, ajo tha se do të mbahet një debat parlamentar dhe do të miratohet një rezolutë ku ka kërkuar që jo vetëm të hiqet kontributi për 15 vite lidhur me përvojën e punës, sepse, nëse qytetari ka punuar qoftë edhe një vit ka aq të drejtë të marrë pension dhe tha se për këtë pret edhe mbështetjen e kolegëve deputetë. Ajo tha se si hap i domosdoshëm është ndryshimi i udhëzimit administrativ, pasi që ligji duhet të ndryshohet, por merr kohë. Ajo tha se komunat obligohet të paguajnë udhëtimet e fëmijëve mbi katër kilometra të gjithëve, por fëmijëve me nevoja të veçanta në veçanti. Ndërsa komunat thonë se nuk i kemi të specifikuar shpenzimet, ndërsa, më pas pyeti Avokatin e Popullit lidhur me këto raste. Tha se raportin për përdorimin e narkotikëve me fëmijë është me interes ta kenë si komision.

Saranda Bogujevci tha se ajo çka i intereson është lidhur me çështjen e Astrit Deharit, është thënë se ka pasur me u përfshirë në raport, ku tregon për shkeljet e ligjeve në këtë rast dhe cila ka qenë arsye që nuk është përfshirë në këtë raport.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se lidhur me ankesat dhe peticionet të adresuara nga qytetarët nuk po mund të kemi përgjigjeje shumë të shpejta dhe të duhura, nëse i referohem kërkesës nga mandati i kaluar të punëtorëve të fabrikës së gypave në Ferizaj, ju kemi adresuar juve si Institucion në mënyrë që ju të lëvizni në këtë drejtim, çështje tjetër ka qenë mohimi i familjarëve të dëshmoreve, të cilëve ju mohohet e drejta për marrjen e pensionit edhe të dëshmorit edhe kontribut dhënës dhe nuk është bërë asnjë hap deri tash për t'u dhënë zgjidhje. Ajo gjithashtu përmendi çështjen e heqjes nga skemat pensionale të familjeve kur fëmija i mbush 5 vjet, si ti shtyjme këto procese përpara së bashku. Ajo u interesua edhe për çështjen e azbestit në komunën e Hanit të Elezit, dhe se si mund të ndihmojnë si deputetë në këtë drejtim, pyeti se a ka raport se si po trajtohen të riatdhësuarit në Kosovë, dhe tha se të ndihmohet lidhur me zbatimin e ligjit për barazi gjinore në ligjin për zgjedhjet.

Mirjeta Kalludra tha se lidhur me pagesën e rrymës së harxhuar në pjesën veriore me iniciativën e IAP, është ndërprerë ajo praktikë, por për pjesën e kompensimit nuk po shihet që ka rezultat deri më tani. Ajo po ashtu pyeti edhe lidhur me sëmundjen e kancerit, tha se në vendet të tjera pacienti obligohet në bërjen e analizave edhe nëse nuk është i sëmurë, si të bëhet një vetëdijesim nga ana e shtetit, në mënyrë që të nxiten qytetarët që t'i nënshtrohen kryerjes së analizave dhe që të ndikohet në preventivën e sëmundjes.

Veton Berisha tha se çështjet që kanë të bëjnë me minoritete janë trajtuar me prioritet dhe disa prej tyre kanë gjetur zgjidhje, tha se i intereson si Institucion si jeni duke e parë përfaqësimin e komuniteteve nëpër institucione publike në përgjithësi dhe sidomos në institucionet e sigurisë në polici dhe FSK, sepse del se ligji po zbatohet, 10 % e komuniteteve përfshihet nëpër këto institucione, por janë të favorizuar serbët, ai po ashtu tha se dihet se kemi probleme ende me uzurpime dhe sa janë duke u trajtuar me prioritet këto raste në sistemin e drejtësisë.

Shemsi Sylja tha se është mirë që keni spikatur çështjen e diskriminimit të qytetarëve të Kosovës Lindore, është shumë interesante që organet shtetërore e përfillin një rregullore që është bërë nga UNMIK- u dhe qëllimi kryesor atëherë ka qenë që mos të rritet numri i shqiptarëve në Kosovë, siç propagandohej, dhe shteti i ynë ende i mban sytë mbyllur. Një çështje tjetër që i intereson është një shkelje që u bëhet ish të plagosurve të viteve 80-ta, e këndeje e që vuajnë si invalid të plagëve të marra e nuk gëzojnë asnjë të drejtë. Ne i kemi ankesat e tyre, e me siguri që u janë drejtuar edhe juve si institucion.

Ai në fund pyeti Avokatin e Popullit se si është gjendja e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, po ashtu tha se i intereson ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

Luljeta Veselaj-Gutaj tha se sa i përket sistemit gjyqësor me shtimin e numrit të gjyqtarëve a ka pasur rënie të lëndëve, a keni ndonjë informacion për këtë? Lidhur me mediat tha se mediat e lira në Kosovë, e sidomos me fokus të veçantë portalet elektronike a po i shkelin të drejtat e njeriut? Ajo, po ashtu, tha se shqetësuese janë bërë edhe vjedhjet si në pronat publike ashtu edhe ato private, cilat janë rekomandimet e juaja si Institucion që i keni dhënë për sigurinë e

qytetarëve të Kosovës? Më pas pyeti Avokatin e Popullit a keni pasur ndonjë ankesë për ligjin për arsimin para universitar nga komunat, e sidomos nga Komuna e Prishtinës që po shkelet ky ligj në nenin 17.

Hilmi Jashari, më pas iu përgjigj pyetjeve të deputetëve, ku lidhur kushtëzimet për pensione me afatin e punës prej 15 viteve, theksoi se kanë konstatuar se është shkelje e të drejtave të njeriut, dhe kemi propozuar që modeli që aplikohet në vendet e Ballkanit që është mundësia e blerjes së stazhit me të cilën qytetarit i zvogëlohet pjesa e kontributeve pensionit që e merr, mirëpo një pjesë e saj i paguhet shtetit mundet me marr vlerën 90% të pensionit dhe 10% i mbetet shtetit dhe përfitimi është i dyanshëm dhe kjo mbetet në vullnetin e deputetëve.

Lidhur me rastin e Astrit Deharit e kanë përcjellë dhe u ka interesuar me pa procesin gjyqësor dhe gjatë procesit të monitorimit të procesit gjyqësor me pa a ka pasur shkelje të drejtave të njeriut në kuptimin e procesit gjyqësor që është realizua. Në këtë rast ka vonesë të panevojshme në ekspertiza, e që ja ngrit kompleksitetin vetë çështjes dhe do të dalim me një raport sepse po del që ky proces gjyqësor nuk është duke shkuar në rrugë të mbarë dhe nuk është në pajtim me standardet e Konventës Evropiane për një gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm brenda një afati kohore të përshtatshëm.

Lidhur me pyetjet tjera që u parashtruan, theksoi se kemi rekomandime për ato çështje dhe duhet të kërkohet në kuvend që Institucionet ato rekomandime t'i zbatojnë dhe të ndryshohen ato ligje ku është e nevojshme.

Sa i përket riatdhesimit u përmend rasti i fundit, kemi mekanizmin për mbrojtje kundër torturës ku ka qenë në vizitë, kemi vizituar edhe fëmijët, tani do të dalim me një raport për të konstatuar nëse trajtimi ka qenë i dinjitetshëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Sa i përket listës esenciale të barnave, si dhe trajtimi i sëmundjeve kemi pasur një takim me Ministrinë e Shëndetësisë, Autoritetin e barnave dhe kemi mundur me vërejtur që prej vitit 2012 nuk është bërë asnjë herë rifreskimi i listës esenciale të barnave që këtyre qytetarëve që vuajnë nga sëmundjet kancerogjene e të tjera, u garantohet nga ana e shtetit përkrahja me këto lloj të barnave. Një pjesë e madhe e këtyre branave ka dështuar për herën e tretë në tenderët që organizon Ministria e Shëndetësisë, shumë shpejt do të dalim me një qëndrim që nëse shteti dështon për t'i siguruar atëherë së paku ka për obligim faturën ta paguajë.

Për qytetarët e Kosovës Lindore mendoj se rekomandimet që i kemi dhënë japin një pasqyrë të qartë, është mirë të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme në takim për të parë cilat veprime i ka ndërmarë, është një situatë e paligjshme sepse ata qytetarë nuk po mundën me i rregulluar as çështjet themelore civile, prej certifikatave të lindjes e deri te diplomat e shkollës që i ndjekin këta fëmijë.

Lidhur me atë se nëse mediat po i shkelin të drejtat e njeriut me rastin e publikimit të informatave, në shumë raste kemi mundur me pa se ka keqpërdorim dhe shkelje të drejtave të njeriut, ku edhe fëmijët ekspozohen në medime.

Kryetarja falënderoi Avokatin e Popullit për paraqitjen e raportit dhe përgjigjet që i dha.

Më pas kryetarja hodhi në votim Raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2018 dhe konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime votoi dhe nxori këtë:

#### Rekomandim

Kuvendi të miratojë Raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2018.

## **2. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin nr.06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës**

Kryetarja, tha se komisionet e përhershme nuk kanë bërë vërejtje në amendamentet e Komisionit FunkSIONAL sa i përket këtij projektligjit dhe ne duhet ta procedojmë për shqyrtim dhe miratim në Lexim të dytë në Kuvend,

Kryetarja, më pas hodhi në votim Raportin përfundimtar të Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe konstatoi se komisioni me vota unanime miratoi këtë Raport dhe nxori këtë;

### **Rekomandim**

Komisioni i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës, me amendamentet e propozuara.

## **3. Të ndryshme**

Mexhide Mjaku- Topalli, kryesuese e grupit punues për nismën ligjore lidhur me plotësim ndryshimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, tha se kemi mbajtur Tryezën lidhur me këtë çështje dhe nga ajo tryezë ka rezultuar se ka nevojë për një Projektligj të ri për mbrojtje nga dhuna në familje, dhe i propozoi anëtarëve të Komisionit FunkSIONAL që të mbështesin propozimin e grupit punues.

Më pas, kryetarja, konstatoi se Komisioni FunkSIONAL miratoi propozimin e lartpërmendur të paraqitur nga kryesuesja e grupit punues, Mexhide Mjaku-Topalli, lidhur me këtë nismë ligjore.

Kryetarja, po ashtu tha se duhet të miratohet edhe ekspertiza e ekspertit lidhur me nismën ligjore për Projektligjin për mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Më pas, kryetarja konstatoi se Komisioni FunkSIONAL miratoi ekspertizën e ekspertit Flamur Hyseni lidhur me Projektligjin për mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Kryetarja tha se në mbledhje të komisioni është prezent edhe një mysafire nga Novi Pazari, znj. Selma Gogiq,

Selma Gogiq, përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe tha se në të ardhmen mundën me e rritur bashkëpunimin e ndërsjellë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit*

**Kryetarja e komisionit,**

---

